

K Ë R K E S Ë

PËR SHPALLJE TË VDEKUR TË YMER KADRI SHALËS

GJYKATËS SË RRETHIT TË DURRËSIT

Kërkuese: Haxhire Mehmet Topçiu (Shala), e datëlindjes 9.7.1961, banuese në lagjen 11, rruga “A.Goga”, nr.8 Durrës, me kombësi e shtetësi shqiptare.

Objekti: Kërkohet deklarimi i shpalljes “person i zhdukur” i shtetasit Ymer Kadri Shala, në bazë të nenit 15 e vijues të Kodit Civil dhe të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Unë e interesuara Haxhire Topçiu kam qenë e martuar me shtetasin Ymer Shala, i datëlindjes 13.10.1956. Sipas dokumenteve që disponoj, sikurse është dhe vendimi nr.260, datë 11.5.1990 i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, unë kam bërë zgjidhjen e martesës për fajin e të paditurit dhe dy fëmijët e mitur Geraldina dhe Hektori më janë lënë mua për rritje dhe edukim. Që nga ajo kohë ata rrinë me mua.

Pas zgjidhjes së martesës, në fillim të vitit 1991, ish-bashkëshorti im, është larguar jashtë shtetit, por se ku nuk e dimë as ne dhe as njerëzit e familjes së tij. Nga koha e largimit e deri më sot, ai nuk është bërë fare i gjallë, nuk ka dërguar letra, nuk ka marrë në telefon dhe as është interesuar për fëmijët e tij, qëndrim të cilin e konfirmojnë dhe njerëzit e familjes së tij. Meqenëse unë si nënë e fëmijëve dua të realizoj plotësisht të drejtat juridike civile të fëmijëve të mi, nisur nga fakti se që nga koha e largimit e deri tani, ish babai i tyre nuk është bërë i gjallë, kërkoj nga ana e gjykatës që të merret vendim për deklarimin e zhdukjes së tij si person.

KËRKUESE
Haxhire Topçiu